



## I. NJOFTIM PËR SHTYP PËR FILLIMIN E PROCESIT TË KOMPENSIMIT

### I NDERUAR DEPOZITUES!

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), në zbatim të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, informon: Këshilli Drejtues i ASD-së me vendimin e tij nr.1 datë 5.12.2022 vendosi të fillojë procesin e kompensimit të depozitave të siguruara depozituesve të bankës së falimentuar **A**

Niveli maksimal i kompensimit është deri në shumën 2.500.000 lekë për çdo depozitues.

- Numri total i depozituesve që do të kompensohen është 64,292 persona
- Shuma totale në lekë që do të paguhet nga ASD është 32,117,599,524 Lekë
- Kompensimi i depozitave do të kryhet në monedhën vendase, në Lek.
- Kompensimi i depozitave në monedhë të huaj do të kryhet në lek sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, publikuar në ditën e vendosjes së bankës në likuidim 5.12.2022".

**Mënyra e kompensimit:** Banka Agjente që do të realizojë procesin e kompensimit është **Banka Kombëtare Tregëtare**

- Banka Kombëtare Tregëtare do të operojë nëpërmjet 61 degëve të saj në të gjithë vendin, 26 prej të cilave gjenden në Tiranë;
- Orari i kryerjes së shërbimit do të jetë orari zyrtar **Bankës Kombëtare Tregëtare** nga ora 08- 15;
- Data e fillimit të pagesës së kompensimit është 20.12.2022.
- Depozituesit do të paguhet në cash pranë sporteve të shërbimit.
- Gjithashtu mund të hapni llogari në bankën agjente Banka Kombëtare Tregëtare, ose të kryeni transfertë në një llogari në një bankë tjetër që e përzgjidhni ju.

### Dokumentacioni që duhet të ketë depozituesi i bankës:

1. Depozituesit individë duhet të paraqesin vetëm dokumentin e vlefshëm të identifikimit.
2. Depozituesit tregtarë dhe shoqëritë tregtare duhet të paraqesin:
  - ekstraktin origjinal nga QKB-ja;
  - certifikatën e regjistrimit NUIS, në organin tatimor;
  - dokumentin e identifikimit të administratorit.
3. Për depozituesit që përfaqësohen nga persona të tretë, si dhe për raste të tjera të veçanta, Agjencia gëzon të drejtën të kërkojë dokumentacion shtesë.

### ASD-ja për çdo informacion ka vënë në dispozicion të publikut:

- Numrin e telefonit (pa/me pagese) + 355 42 362 989 që prej orës 8.00-16.00.
- Adresën e-mailit: [info@asd.gov.al](mailto:info@asd.gov.al)
- Faqen WEB të ASD-se: [www.asd.gov.al](http://www.asd.gov.al)
- Profilin e ASD-së në rrjetet sociale.

Informacion të detajuar mund të gjeni dhe pranë sporteve të Bankës Kombëtare Tregëtare si dhe në faqen zyrtare [www.bkt.com.al](http://www.bkt.com.al)

- Kursi i këmbimit është kursi zyrtar i këmbimit të BSH më datë 05.12.2022.
- Dokumentat duhet të jenë të vlefshme. Të paraqitet origjinali ose kopja e noterizuar

*Sigurimi dhe kompensimi i depozitave të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë është qëllimi i krijimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, institucion ky i krijuar në bazë të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Sigurimi dhe kompensimi i depozitave të depozituesve bëhet sipas niveleve të përcaktuara në ligj.*